

DEKRET
Nr. 11886, datë 28.12.2020

PËR EMËRIMIN E GJYQTARIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Në mbështetje të neneve 93, 125, pika 1, 127, pika 3, 129, 149/d, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 7, 7/a, pika 4, 7/b, 7/dh, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; pasi administrova Listën Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve të lejuar për kandidim, dhe Raportin e Arsytuar të Renditjes për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019, pasi u njoha me praktikën dokumentare të vendimmarrjes dhe vlerësimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për kandidatin e lejuar për plotësimin e kësaj vakance, përcjellë me shkresën nr. 551 prot., datë 28.12.2020; pasi vlerësova kandidaten e ngelur në garë për plotësimin e kësaj vakance; si dhe duke vlerësuar njëkohësisht nevojën jetike që ka vendi për plotësimin dhe funksionimin sa më parë dhe në mënyrë të qëndrueshme të Gjykatës Kushtetuese, në përfundim të shqyrtimit vendosa të,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Sonila Bejtja emërohet gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta